REPUBLIKA E SHQIPËRISË

# UNIVERSITETI I ARTEVE

## BORDI I ADMINISTRIMIT

## VENDIM

**Nr. 24, datë 20/09/2021**

**PËR**

**"MIRATIMIN E PAGESËS PËR KREDITE TË STUDENTËVE QË KRYEJNË NJË PROGRAM TË DYTË STUDIMI, NË TË NJËJTIN PROGRAM STUDIMI NË TË CILËN JANË DIPLOMUAR MË PARË, PËR CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE MASTER"**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për "Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; shkresës së Minstrisë së Arsimit të Sportit dhe të Rinisë Nr. 02 Prot, datë 06/01/2021, Vendimit të Senatit akademik Nr. 19, datë 28/06/2018, si dhe në shkresën e Rektorit të Universitwetit të Arteve Udhëzimin të Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr., datë ....''''; pikën 3 të raportit të grupit të punës ''Mbi verifikimin e përshtatshmërisë së programeve të studimit të ciklit të parë dhe të dytë në Fakultetet e Universitetit të Arteve'' si dhe shkresës Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë me nr.02Prot, datë 06.01.2021 si dhe në Relacionin e Rektorit të Universitetit të Arteve ''Për miratimin e procedurave të studentëve që kryejnë një program të dytë studimi, të njëjtin për të cilin janë diplomuar më parë, për ciklin e dytë të studimeve master'', pasi e diskutoi,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e pikës 2 të Vendimit të Senatit sa më lart (bashkëlidhur Vendimit) "***detyrimi financia i studentëve ndaj Uart, për pagesën e tarifës së shkollimit, për program të dytë studimi, të jetë vetëm pagesa e krediteve për lëndët që përcaktohen nga Komisioni i ekuivalentinit";***
2. Miratimin e pikës 3 të Vendimit të Senatit sa më lart (bashkëlidhur Vendimit) "***studentët i nënshtrohen tarifave të miratuara nga strukturat e Uart, për konkurrim dhe rregjistrim, për vitin akademik në të cilin aplikojnë";***
3. Miratimin e pikës 4 të Vendimit të Senatit sa më lart (bashkëlidhur Vendimit) "***nga pika 2 e këtij Vendimi, të përjashtohen studentët e shkëlqyer, në zbatim të nenit 85, të Ligjit nr.80 datë 22/07/2015 për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";***
4. Ky Vendim të publikohet të faqen zyrtare të Uart dhe në transpencë.

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**BORDI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

**Risena Xhaja (Kryetar)**
***Voton Kundër***
*(sipas argumentit në Proçes Verbal)*

**Prof. Besnik Bisha (Anëtar)**

**Prof. Arben Basha (Anëtar)**
***Mungon***

**Aida Martiro (Anëtar)**
***Voton Kundër***
*(sipas argumentit në Proçes Verbal)*

**Prof. Bujar Kapexhiu (Anëtar)**

**Lorenc Vangjeli (Anëtar)**
***Mungon***

**Vladimir Llakaj (Anëtar)**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE**
**SENATI AKADEMIK**

**VENDIM**

**Nr. 19, datë 28.06.2018**

**PËR**
**"MIRATIMIN E PROCEDURAVE TË STUDENTËVE QË KRYEJNË NJË PROGRAM TË DYTË STUDIMI, NË TË NJËJTIN PROGRAM STUDIMI PËR TË CILIN JANË DIPLOMUAR MË PARË, PËR CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE MASTER"**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në nenin 85, nenin 89 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për "Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; pikën 3 të Raportit të Grupit të Punës "Mbi verifikimin e përshtatshmërisë së programeve të studimit të ciklit të parë dhe të dytë në Fakultetet e Universitetit të Arteve" me nr. 6838, datë 10.07.2017 të Sekretarit të Përgjithshëm, i ngritur me Urdhrin e Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë me nr. 616, datë 30.12.2016; si dhe shkresën e Dekanit të Fakultetit të Artit Skenik me nr. 163 prot., datë 06.06.2018 "Për pagesën e tarifës së studimit të disa studentëve që ndjekin program të dytë studimi në Fakultetin e Artit, pasi e diskutoi,

**VENDOSI:**

1. Fakultetet e Universitetit të Arteve, të ngrejnë komisionet e ekuivalentimit për të gjithë studentët të cilët kryejnë një program të dytë studimi, në të njëjtin program studimi për të cilin janë diplomuar më parë, në ciklin e dytë të studimeve master.
2. Ti propozojë Bordit të Administrimit që detyrimi financiar i studentëve ndaj UART për pagesën e tarifës së shkollimit për program të dytë studimi, të jetë vetëm pagesa e krediteve për lëndët që përcaktohen nga komisioni i ekuivalentimit.
3. Studentët i nënshtrohen tarifave të miratuara nga strukturat e UART për konkurrim dhe regjistrim për vitin akademik që ato aplikojnë.
4. Ti propozojë Bordit të Administrimit që nga pika 2 e këtij vendimi të përjashtohen studentët e shkëlqyer, në zbatim të nenit 85, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për "Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".
5. Ky vendim ti dërgohet për miratim Bordit të Administrimit.
6. Vendimi të publikohet në faqen zyrtare të UART.

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**<u>SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE</u>**

**Prof. Kastriot ÇAUSHI** **Prof. Dr. Zana SHUTERIQI (PRELA)**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Asoc. Ardian ISUFI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Fatmir MIZIRI

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Petrika AFEZOLLI

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Rafael HOXHA

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Sadik SPAHIJA

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Miltiadh KUTALI

Prof. Bujar SYKJA

Prof. Asoc. Elvis RUDI

Nansy GJERAZI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI I ARTEVE - TIRANË